

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Përmbytja në Elbasan/ Kryebashkiaku Gledjan Llatja shkurton Fondin e Emergjencës për godina
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/permybtja-ne-elbasan-kryebashkiaku-gledjan-llatja-shkurton-fondin-e-e-i103994
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 08:23:53 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 08:07:29 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1a4d5eb9e2f70b0c6ead19bedde73159c5e78852951498a713a4a907a9ff1f73
TEKSTI	b1c161f655106d49a7bc57354b3feaa5d86116c15806970653eca1d56b203048
PAMJA	af642546066ab1993138ae2c7f85be62ba7c3114cc0c2e2174ea7171627612ac

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	beffd69fbccaaa70e0a84a23e7220f5b1bb46e2d9d0b473371e88fa2ef5f296c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/beffd69fbccaaa70e0a84a23e7220f5b1bb46e2d9d0b473371e88fa2ef5f296c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- EDITORIAL
- EMISIONE
- INVESTIGIME
- AKTUALITET
- SOCIALE
- POLITIKË
- KOSOVA
- BOTA
- SHOWBIZ
- LIFESTYLE
- SPORT

SYRI LIVE




Flash: **daja i deputetes** fshatin Sauk të Roskovecit, pas një k... ■ **te viktimate** shqyrtojë kërkesat e... ■ **shkollor,** edhe me fluksin e makinave ■ **dne Ruman** Nga raketat, bom... ■ **u zhdruk** arriti t'i shqyrtojë vonë ■ **shpallet** në kërkit daia i

AKTUALITET

Përmbytja në Elbasan/ Kryebashkiaku Gledjan Llatja shkurton Fondin e Emergjencës për godina

Piranjat Përditësimi i fundit 14 Shtator 2026, 10:07



Një rrebesh i shpejtë shiu këtë fundjavë, pas një vere shumë të nxehtë, përmbyti tërësisht rrugët e Elbasanit, duke nxjerrë në pah menaxhimin e dobët publik nga Bashkia e qytetit.

Për një trill interesant, akset rrugore u bënë të pakalueshme për orë të tëra, vetëm pak ditë pasi socialistët në Këshillin Bashkiak miratuan një projekt kontrovers të kryebashkiakut Gledjan Llatja, për shkurtimin e Fondeve të Emergjencës.

Në mbledhjen e datës 10 shtator 2026, Këshilli shqyrtoi kërkesën e Bashkisë për "Përdorimin e një pjese të Fondit të Emergjencave për ndërtimin e një stacioni të ri zjarrëfikës". Fondi që merrej nga paratë e destinuar për Emergjencat ishte 10.2 milionë lekë të reja ose më shumë se 110 mijë euro, sipas kursit aktual.

Në Relacionin e hartuar nga zyra e kryebashkiakut Llatja thuhet se ky ndryshim destinacioni të fondeve propozohet "në kuadër të masave për forcimin e kapaciteteve vendore për parandalimin, përgatitjen dhe përballimin e situatave të emergjencave civile dhe rritjen e gatishmërisë për përballimin e situatave të zjarreve...".

Në projektin e Bashkisë së Elbasanit parashikohet ngritja e një stacioni të ri zjarrëfikësesh në zonën e Bradasheshit.

Në foto: Relacioni i Bashkisë Elbasan për zvogëlimin e Fondit të Emergjencave



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E ELBASAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E E POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT URBAN DHE
SHËRBIMEVE INFRASTRUKTURE

RELACION

"Për miratimin e përdorimit të një pjesë të fondit të Emergjencave Civile për ndërtimin godinës së stacionit të ri zjarrfikës në Njësinë Administrative Bradashesh"

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Në kuadër të masave për forcimin e kapaciteteve vendore për parandalimin, përgatitjen dhe përballimin e situatave të emergjencave civile, si dhe për rritjen e gatishmërisë për përballimin e situatave të zjarreve në territorin e Bashkisë Elbasan, Drejtoria e Mbrojtjes Civile propozon përdorimin e shumës prej **10,243,226 (dhjetë milion e dyqind e dyzet e tre mijë e dyqind e njëzet e gjashtë) lekë** nga Fondi i Emergjencave Civile për ndërtimin godinës së stacionit të ri zjarrfikës në Njësinë Administrative Bradashesh. Godina e stacionit të ri do të jetë me përmasa 10*8 dhe lartësi 6 m, ku do të sistemohen automjete zjarrfikës dhe ambientet e shërbimit për personelin (dhomë fjetje, kuzhinë, tualet). Trualli ku do të ndërtohet godina është pronë e bashkisë dhe ndodhet pranë godinës së Njësisë Administrative Bradashesh.

Ndërtimi i godinës në Njësinë Administrative Bradashesh paraqet një nevojë të rëndësishme për garantimin e sigurisë së komunitetit dhe forcimin e kapaciteteve të reagimit ndaj situatave të emergjencës, veçanërisht ndaj rrezikut nga zjarret në një zonë industriale.

Kjo nevojë lidhet edhe me specifikën e territorit të Bradasheshit dhe praninë e një numri subjektësh që ushtrojnë veprimtari prodhuese, përpunuese, magazinuese apo tregtuese të materialeve dhe produkteve me rrezikshmëri të lartë, të cilat, në kushte të caktuara, mund të përbëjnë burim potencial për përhapjen e zjarreve dhe krijimin e situatave me pasoja të rënda për jetën e njerëzve, pronën, mjedisin dhe aktivitetin ekonomik.

Prania e këtyre subjekteve, së bashku me aktivitetet industriale dhe ekonomike që zhvillohen në zonë, kërkon një nivel më të lartë gatishmërie dhe reagimi të shërbimit zjarrfikës, pasi ndërhyrja në rast zjarri duhet të jetë sa më e shpejtë, me qëllim parandalimin e përhapjes së flakëve dhe kufizimin e pasojave.

Në veçanti, në rastet kur një incident ndodh në ambiente ku prodhohen, magazinohen ose tregtohen materiale të rrezikshme, koha e reagimit është një faktor përcaktues për sigurinë e jetës së punonjësve dhe banorëve të zonës, si dhe për shmangien e përshkallëzimit të situatës.

Aktualisht, mbulimi i zonës nga strukturat zjarrfikëse ekzistuese nuk garanton në çdo rast një reagim sa më të shpejtë ndaj emergjencave që mund të ndodhin në territorin e Bradasheshit dhe

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400151, e-mail: bashkia@elbasan.gov.al web: www.elbasan.gov.al

Në foto: Relacioni i Bashkisë Elbasan për zvogëlimin e Fondit të Emergjencave

Opozita e djathtë në Këshillin Bashkiak të Elbasanit e kundërshtoi këtë projekt të kryebashkiakut Gledjan Llatja. Duke e vlerësuar ngritjen e një stacioni zjarrfikësish si të domosdoshëm, këshilltarëve opozitarë u shprehën tërësisht kundër shkurtimit të Fondeve të Emergjencës për këtë projekt të ri.

Kryetarja e këshilltarëve opozitarë, **Bianka Çopja**, deklaroi në mbledhje se grupi që ajo përfaqëson mbështet idenë e forcimit të kapaciteteve për zjarrfikësit, megjithatë, vendimi për shkurtimin e Fondeve të Emergjencës është një veprim tërësisht i pamatur dhe në kundërshtim me interesat e qytetarëve të Elbasanit.

"Duhet të jemi të qartë se nuk jemi kundër ndërtimit të një stacioni zjarrfikës, por jemi kundër të përdorimit të fondit të Emergjencave për rikonstruksion apo ndërtim godine. Fondi i Emergjencave Civile ka një qëllim shumë të qartë-të përdoret në situata emergjente dhe jo për mungesë të planifikimit të Bashkisë për ndërtim", tha Çopja gjatë një debati me kryebashkiakun Llatja.



Në foto: Këshilltarja opozitare, **Bianka Çopja**, kundërshtoi uljen e Fondit të Emergjencave

Më tej, ajo theksoi se, nëse ndërtimi i një godine të re për zjarrfikësit ka qenë e nevojshme, "Bashkia duhet ta kishte planifikuar këtë ndërtim që në kohën e hartimit të Buxhetit për vitin 2026".

Duke vijuar me kundërshtinë e saj, kryekëshilltarja opozitare Çopja i sugjeroi Bashkisë që "ta shtyjë miratimin e këtij projekti për vitin e ardhshëm, duke qenë se edhe viti aktual po mbaron. Në dhjetor planifikohet buxheti i ri. Ndaj, nuk kemi pse prekim fondin e Emergjencave Civile, sepse nuk mund si rubrikë buxhetore, sa herë Bashkisë i duhet një investim i ri".

Çopja u bëri thirrje këshilltarëve socialistë që "të mos e prekin fondin e emergjencës, pasi, përballë një situatë të vështirë, Elbasani nuk do të ketë mundësinë të përballojë asnjë problematikë madhore".

Qëndrimi dhe thirrja e opozitës nuk ndikoi aspak në vendimmarrjen e këshilltarëve socialistë, të cilët miratuan me shumicën e votave projektin e Bashkisë për të shkurtuar me plot 110 mijë euro Fondin e Emergjencave Civile, një vlerë që është më shumë se një e katërta e fondit vjetor për këtë fushë.

Pasojat e vendimmarrjes së këshilltarëve të shumicës u panë qartë gjatë fundjavës, sidomos ditën e shtunë, kur disa minuta shi, përmbytën tërësisht rrugët e qytetit. Me dimrin e prishëm, qyteti i Elbasanit pritet të përballë me situata akoma më të vështira, ndërkohë që mbetet për t'u parë se sa do të jenë të mjaftueshme fondet që ka Bashkia për Emergjencat Civile. **Bold News**

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 14 Shtator09:54

[Rradhë kilometrike dhe kaos në rrugë me nisjen e vitit të ri shkollor, deri në Paskuqan](#)

Tirana po përballlet ditën e sotme me një trafik të rënduar, i cili përkon edhe me fluksin e makinave në ditën e parë...

AKTUALITET 14 Shtator09:48

Përplasje mes policisë dhe protestuesve pranë shkollës “Qemal Stafa”, dhjetëra të shoqëruar

Një grup protestuesish është ndalur pranë shkollës “Qemal Stafa”, në momentin kur aty po këndohej himni kombë...

AKTUALITET 14 Shtator09:31

Alket Rizai duhej të kthehej sot në burg, por u zhduk pas të shtënave me armë/ Si ndodhi sherri në plazhin grek

Nga analiza e pamjeve filmike, të cilat policia arriti t’i shqyrtojë vonë pasdite, u konfirmua se një nga personat kryesorë t&e...

AKTUALITET 14 Shtator08:42

Nis sot viti i ri mësimor 2026-2027! 25 mijë fëmijë ulen për herë të parë në bankat e shkollës

Në të gjitha shkollat e vendit nis sot viti i ri mësimor, ditë me emocione sidomos për 25 mijë fëmijët që ulen p&...

AKTUALITET 14 Shtator08:32

Dyshohet se plagosi me çekiç ish-vjehrrin, shpallet në kërkim daja i deputetes Zegjine Çaushti

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur mbrëmjen e djeshme në Roskovec, ku një person plagosi me çekiç ish-vjehrrin e ...

AKTUALITET 14 Shtator08:10

Vajza e saj 10 muajshe ishte me temperaturë/ Gazetarja rrëfen eksperiencën në QSUT: Prindërit përballen me arrogancë dhe poshtërim

Gazetarja Bora Shahini ka rrëfyer eksperiencën e saj në Pediatrinë e QSUT-së, pas një rasti që kishte të bënte me...

AKTUALITET 14 Shtator07:58

“Nuk e kuptoj çfarë përbindëshash jeni”/ Letra e Nazmi Berishës nga Burreli për Mehmet Shehun, dëshmia që rrëzon mitin komunist të “atdheut mëmë”

Ka dokumente që nuk kanë nevojë për shumë koment. Mjafton t’i lexosh fjalët dhe e kupton menjëherë se çfa...

AKTUALITET 14 Shtator07:54

AKEP ndalon klauzolat e indeksimit, rritja e çmimit të celularëve duhet të parashikohet në vlerë

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) do të ndalojë aplikimin e klauzolave të ndryshimit të tarifave, të shprehura...

AKTUALITET 14 Shtator07:46

Sherr me babain e ish-bashkëjetueses, e plagos me çekiç! Në kërkim autori

Një plagosje ka ndodhur mbrëmjen e djeshme në fshatin Suk të Roskovecit, ku një shtetas dyshohet se është goditur me &ccedi...

AKTUALITET 14 Shtator07:38

Emigracioni/ BE ka dhënë 1.1 milionë leje qëndrimi për shqiptarët, në Gjermani numri arrin rekordin e 124 mijë

Emigracioni i shqiptarëve drejt Bashkimit Europian ka mbetur sërish me ritme të larta në 10 vitet e fundit, dhe gradualisht po tejkalon va...

ME TE VIZITUARAT

BOTA 13 Shtator

"Kaos" në fluturimin Australi-Katar/ Dy burra p...

Një incident është regjistruar në bordin e një fluturimi nga Melbourne drejt Dohas, ku dy pasagjerë meshkuj u bënë agre...

AKTUALITET 13 Shtator

"Dil jashtë", u përplas me Edi Ramën për "Terri..."

Mes debateve dhe përplasjeve, kështu është zhvilluar mbledhja e kësaj të diele mes kryeministrit Edi Rama dhe komunitetit të...

BOTA 13 Shtator

A mund t'i mbijetojë tregu i naftës një lufte t...

Lufta mes SHBA-së dhe Iranit ka zgjatur shumë më tepër nga sa pritej, por pavarësisht tronditjeve, tregu global i naftës ka tregua...

Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Reagon Cllevio!





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.